



VENDIM I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 8 prill 2013

Nr. i lëndës: 2012-15

Shfaqet Emërllahu

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 prill 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim::

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 18 tetor 2012.

II. FAKTET

2. Më 4 korrik 2008, prokurori i Qarkut të Gjilanit ka akuzuar një R.E. për vrasje të rëndë, të kryer me qëllim të përfitimit të pasurisë, dy pika të vrasjes së rëndë në tentativë dhe posedim të paligjshëm të armëve të

zjarrit. Në bazë të dokumenteve të parashtruara nga ankuesi shihet se R.E. është kushëriri i tij, mirëpo ai nuk ofron ndonjë hollësi mbi marrëdhëniet e tyre.

3. Më 2 qershor 2009, Gjykata e Qarkut e Gjilanit e ka dënuar R.E., duke e akuzuar dhe dënuar me nëntëmbëdhjetë vjet burgim.
4. Pas ankesës të parashtruar nga avokati mbrojtës i të pandehurit, më 7 korrik 2010 Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës në një vrasje të rëndë për hakmarrje. Gjykata ka konfirmuar pjesën tjetër të vendim të shkallës së parë.
5. Më 26 nëntor 2010, Gjykata Supreme e ka refuzuar kërkesën e të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë.

III. ANKESAT

6. Ankuesi pretendon se prokurorët e EULEX-it nuk kanë vepruar dhe hetuar rastin siç duhet. Ai gjithashtu ankohet në thelb se procedurat pranë gjykatave të Kosovës ishin të padrejta.

IV. LIGJI

7. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojnë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Në përputhje me rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës, ankesa duhet të dorëzohet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar.
9. Paneli konstaton se vendimi përfundimtar në rastin në fjalë ishte marrë më 26 nëntor 2010. Ankesa është parashtruar më 18 tetor 2012, prandaj bie jashtë afatit kohor gjashtë-mujor të parashikuar në rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës. Prandaj ankesa nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
10. Paneli vëren më tej se sipas rregullës 25, paragrafin 1 të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat nga personat që pretendojnë të jenë viktimat të shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganave.

11. Sa i përket kuptimit të fjalës "viktimë", Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka gjetur në shumë raste se një "viktimë" sipas Konventës tregon personin, i cili është i prekur drejtpërdrejtë nga veprimi apo mosveprimi në fjalë (shih, në mesin e shumë autoriteteve, Amuur kundër Francës, 25 qershor 1996, paragrafi 36, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1996-III). Në disa raste, kur ka pasur një lidhje personale dhe specifike në mes të viktimës së drejtpërdrejtë dhe aplikuesit, Gjykata ka pranuar kërkesën nga ai person, i cili ishte konsideruar si një viktimë jo e drejtpërdrejtë. Nëse personi është viktimë e tillë varet nga ekzistenca e faktorëve të veçantë që i japin vuajtjes së aplikuesit një dimension dhe karakter të dallueshëm prej shqetësimit emocional që mund të konsiderohet se i është shkaktuar në mënyrë të pashmangshme të afërmve të viktimës së një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut. Elementet relevante do të përfshijnë, mes tjerash, ekzistencën dhe afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, shkallës në të cilën personi ka qenë dëshmitar i ngjarjeve në fjalë (shih, *mutatis mutandis*, Kurt kundër Turqisë, vendimi i 25 majit 1998, Raportet 1998-III, paragrafët 130-134; *Yaşa kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 2 shtator 1998, Raportet mbi gjykimet dhe vendimet 1998-VI, paragrafi 71; dhe anasjelltas, *Çakic kundër Turqisë* [GC], nr. 23657 / 94, paragrafët 98-99, KEDNj 1999-IV). Paneli ka përvetësuar qasjen e zhvilluar nga KEDNj-ja si të veten në raste të tilla. Rregullorja e punës nuk parashikon sjelljen e një *actio popularis*; nuk lejon që individët të ankohen kundër veprimeve apo mosveprimeve të pretenduara të EULEX-it *in abstracto* thjesht sepse ata mendojnë se ato shkelin të drejtat e njeriut (shih lëndën e PSHDNj-së, nr. 2012-07, *Ibishi kundër EULEX-it*, paragrafi 7).
12. Paneli vëren se ankuesi nuk ofron ndonjë hollësi, të cilat do të mund ta vërtetonin se marrëdhënia e tij me R.E. është mjaft afër sa për ta konsiderojnë atë si një viktimë të tërthortë të shkeljeve të pretenduara. Gjithashtu nuk ka asnjë indikacion se të drejtat e ankuesit kanë qenë të prekura direkt në ndonjë mënyrë.
13. Prandaj Paneli konkludon se ankuesi nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it brenda kuptimit të rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se sipas Nenit 29 (d) të rregullores së punës ankesa është e pabazuar, dhe

SHPALL KËTË ANKESË TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesues i Panelit